

## Raca e tretë (2:11–18)

**K**ent Hughes tregoi një histori për Xhon Rid, i cili punonte si shofer autobuzi në një shkollë në Australi. Autobuzi transportonte nxënës të bardhë dhe aborigjenë. Djemtë ziheshin dhe bënin zhurmë vazhdimisht. Më në fund, Xhoni nuk duroi më. Ai ndaloi autobuzin në anë të rrugës dhe u tha djemve të bardhë: «Çfarë ngjyre jeni?»

«Të bardhë.»

Xhoni tha: «Jo, jeni jeshilë. Të gjithë djemtë që udhëtojnë me këtë autobus janë jeshilë. Pra, çfarë ngjyre jeni?»

Djemtë e bardhë u përgjigjën: «Jeshilë».

Pastaj Xhoni u foli aborigjenëve dhe u tha: «Çfarë ngjyre jeni?»

«Të zinj», u përgjigjën ata.

«Jo, jeni jeshilë. Të gjithë djemtë që udhëtojnë me këtë autobus janë jeshilë. Pra, çfarë ngjyre jeni?»

Aborigjenët u përgjigjën: «Jeshilë».

Kjo u duk sikur e pushoi për një moment sherrin. Pas disa kilometrash, njeri nga djemtë u tha të tjerëve: «Në rregull, ata që janë ngjyrë jeshile e hapur të dalin në këtë anë. Ata që janë jeshile e errët të dalin në anën tjetër.» Pastaj sherri nisi përsëri.

Megjithëse zgjidhja që Xhoni dha nuk zgjati, ai e dinte se çfarë duhej. Për situatën e krijuar në atë autobus duhej një racë e re, pa dallime ngjyre, pa të bardhë e të zinj, por vetëm me jeshilë. Që njerëzit të jetojnë në harmoni, nuk duhet të bëhen dallime

midis tyre.

Letra e Palit drejtuar efesianëve flet për krijimin e një race të re. Ai shpall se Jezusi erdhi në tokë për të krijuar një racë të re.

Disa vite pas shkrimit të letrës së Efesianëve nga Pali, Klementi i Aleksandrisë, një kristian i shek. II, tha për këtë racë të re në një nga shkrimet e tij: «Ne që e adhurojmë Perëndinë në një mënyrë të re, si raca e tretë, jemi kristianë».

Kristianët janë një racë e tretë. Ne jemi kombi i ri i Perëndisë.

Prandaj kujtohuni se dikur ju johebrenj në mish, të quajtur të parrethprerë nga ata që e quajnë veten të rrethprerë, sepse të tillë u bënë në mish, nga dora e njeriut, ishit në atë kohë pa Krishtin, të huaj në qytetërinë e Izraelit dhe të huaj për besëlidhjen e premtimit, pa pasur shpresë dhe duke qenë pa Perëndi në botë. Por tani, në Krishtin Jezus, ju që ishit larg, u afruat me anë të gjakut të Krishtit. Ai në fakt, është paqja jonë, ai që ka bërë nga të dy popujt një dhe ka shembur murin e ndarjes, duke e prishur armiqësinë në mishin e tij, ligjin e urdhërimeve të përfutur nga porosi, për të krijuar në vetvete nga dy një njeri të ri, duke bërë paqen, dhe për t'i pajtuar të dy me Perëndinë në një trup të vetëm me anë të kryqit, mbasi vrau armiqësinë në vetvete. Dhe ai erdhi për t'ju shpallur paqen, juve që ishit larg dhe atyre që ishin afër, sepse përmes tij që të dy kemi hyrje tek Ati nëpër një Frymë të vetme (2:11–18).

Të vërtetën e shprehur nga këto vargje mund ta përmbledhim në një fjali si më poshtë: «Jezusi do që kristianët ta kuptojnë se ata janë një racë e re njerëzish.»

## **NE E VLERËSOJMË MË SHUMË RACËN E RE DUKE KUJTUAR TË KALUARËN TONË**

Pse duhet të entuziazmohemi për faktin se jemi pjesë e kësaj race të re? Përgjigjja gjendet në vargjet 11 dhe 12. Vlerësimi për racën e re rritet ndërsa mendojmë për jetën e kaluar. Një fjalë e përshkruan atë jetë, ndarje apo largim. Jeta e vjetër ishte ndarje nga Perëndia dhe nga njerëzit e tjerë.

Kjo botë nuk është një vend «një për të gjithë dhe të gjithë për një» apo jo? Njerëzit në këtë botë nuk ia kalojnë mirë me njëri-tjetrin. Midis kombeve ekzistojnë mosmarrëveshje. Në qytetet e mëdha «të fortët» shënojnë kufijtë e territorit të tyre dhe vrasin ata që i kalojnë ato. Në shtëpitë tona ka grindje familjare. Normat e larta të divorcit e tregojnë këtë. Edhe në kishë bëhen dallime dhe disa njerëz veçohen prej të tjerëve. Ndarja e karakterizon botën tonë.

Pali e ngre këtë problem. Kristianizmi nuk i shmanget dot problemit të përpjekjeve të dështuara të njerëzimit për të ndërtuar marrëdhënie të mira me njëri-tjetrin. Në fakt, Pali e pa kristianizmin të ndeshet ballë për ballë me këtë çështje. Në botën e asaj kohe, kur Pali jetoi, dy grupe njerëzish ishin ndarë tërësisht nga njëri-tjetri. Këta ishin hebrenjtë dhe jo hebrenjtë. Hebrenjtë i quanin johebrenjtë «të parrethprerë». Ata e përdornin këtë emër për të tallur e përqeshur një racë të tërë. Thuhet se, kur pyetën një rabi (mësues të fesë izraelite) se pse Perëndia krijoi kaq shumë johebrenj, ai u përgjigj: «Që të kishte lëndë djegëse të mjaftueshme për zjarrin e Gehenës (ferrit)».

Armiqësia midis këtyre dy grupeve ishte kaq e madhe sa që ishte e paligjshme që një hebre të ndihmonte një johebre të lindte, do me thënë ta ndihmonte të sillte një johebre tjetër në botë. Në qoftë se një hebre do të martohet me një johebre, familja e tij do ta konsideronte të vdekur dhe do të organizonte një ceremoni varrimi për të, për të deklaruar ndarjen përfundimtare nga ky anëtar i familjes. Kur një hebre futej në Palestinë, ai shkundte pluhurin nga këmbët, në mënyrë që pluhuri i johebrenjve të mos ndoste tokën e shenjtë. E tillë ishte urrejtja e hebrenjve kundrejt johebrenjve. Johebrenjtë i konsideronin hebrenjtë në të njëjtën mënyrë. Ata i përbuznin hebrenjtë.

Pali u shkroi kristianëve johebrenj, të cilët e dinin që nga fëmijëria se përbuzeshin nga hebrenjtë dhe, nga ana e tyre, dikur i kishin urreyer hebrenjtë, gjithashtu. Pali e dërgoi këtë letër për t'u bërë të

njohur këtyre kristianëve johebrenj se ata ishin bërë pjesë e një race të re që përfshinte hebrenj dhe johebrenj. Brenda kësaj race nuk kishte më urrejtje, mospëlqim dhe keqtrajtim racial.

Te Efesianëve 2:11–12 flitet, gjithashtu, për paqen e bërë midis krijesave të Perëndisë. Largësia dhe marrëdhëniet e ftohta midis të dy racave ishin eliminuar tashmë. Në vargun 12, Pali përshkruan largimin e johebrenjve nga Perëndia dhe pasojat e këtij largimi (ndarjeje).

1. «*Ishit...pa Krishtin.*» Johebrenjtë nuk e dinin se e gjithë historia e njerëzimit e gjente kuptimin dhe qëllimin te Jezu Krishti.

2. «*Ishit...të huaj në qytetërinë e Izraelit.*» Johebrenjtë nuk merrnin të drejtat e nënshtetësisë (që nënkuptonte një marrëdhënie të veçantë me Perëndinë) që u përkisnin pasardhësve të Abrahamit që nga lindja.

3. «*Ishit...të huaj për besëlidhjen e premtimit.*» E vetmja gjë që mund të bënin ishte të shikonin si spektatorë marrëdhënien e veçantë midis Perëndisë dhe kombit izraelit.

4. «*Ishit...pa pasur shpresë.*» Ata nuk kishin shpresë, sepse nuk kishin Krishtin.

5. «*Ishit...pa Perëndi.*» Ata nuk e njihnin Perëndinë. Ata nuk kishin marrëdhënie të vërteta me Të.

Glen Ouen pati një përvojë prekëse gjatë udhëtimit të tij në Rusi. Ai takoi një grua në Kiev. Ajo, me një Bibël në dorë, i tha: «Po mbaj në duar shpresën e botës». Për këtë ngjarje Glen shkroi:

...E pashë dhe një lëmsh m'u mblodh në grykë....Kishte trishtim në zërin e saj, trishtim në sytë e saj, trishtim në zemrën e saj. Por kishte në këtë grua të mirë një frymë shprese. Në zemrën e saj të vrarë digjeshin flakët e shpresës që gjithmonë digjen brenda atyre që kanë Perëndinë. Ajo e dinte se, ndërsa përkëdhelte me kujdes Biblën, Perëndia ishte shpresa e saj....

Derdhëm lot bashkë me të, ndërsa dëgjuam historinë e saj dhe ndamë dhembjen me të. Djali i saj i vetëm kishte vdekur tetëmbëdhjetë muaj më parë nga rrezatimi radiaktiv, si pasojë e shpërthimit bërthamor në Çernobil. I shoqi kishte vdekur nga mungesa e trajtimit të duhur mjekësor vetëm tre muaj më parë. Tani ajo po kërkonte ngushëllim dhe shpresë.

...Kjo grua e dashur dhe e qetë nga Ukraina e dinte se shpresa e saj banonte në Jezu Krishtin, Birin e Perëndisë. Qeveria e shtetit të saj e kishte braktisur. Jeta në një farë kuptimi e kishte braktisur. Njerëzit e saj më të dashur kishin vdekur tashmë. E vetme, ajo nuk kishte asnjë burim njerëzor ku të mbështetej. Ajo nuk kishte asnjë shpresë tjetër përveç Jezusit. Ai është shpresa e vetme për të gjithë ne.

Pa Jezusin ne të gjithë ishim pa shpresë, por Jezusi i shndërroi jetët tona. Ai e ofron këtë mundësi për të gjithë ata që kthehen drejt Tij. Tamam atëherë kur thoni: «Ç'farë dobie ka? Ç'më duhet mua?», tamam atëherë kur jeta juaj duket se nuk po shkon gjëkund, se s'ka asnjë drejtim, Jezusi vjen dhe ndryshon çdo gjë.

Vini re se si Pali e pohon këtë në vargun 13: «Por tani, në Krishtin Jezus, ju që dikur ishit larg, u afruat me anë të gjakut të Krishtit.» Vini re se kuptimi i këtij vargu është se të qenit «në Krishtin Jezus» ndryshon çdo gjë. Fjalët: «Në Krishtin Jezus» përshkruajnë racën e re, e cila është një bashkësi njerëzish të sjellë në jetë» me anë të gjakut të Krishtit».

### **PERËNDIA VETË NA BËN PJESË TË RACËS SË RE**

Ia detyrojmë pjesëmarrjen tonë në racën e re tërësisht Jezusit. Vetëm Jezusi është Ai që e bëri të mundur ekzistencën e racës së re. Si e bëri Jezusi këtë? Le të shqyrtojmë foljet që gjenden në vargjet 15 dhe 16.

Së pari, Jezusi e bëri të mundur ekzistencën e racës së re «duke e prishur armiqtë në mishin e tij, ligjin e urdhërimeve të përfutur nga porosi». Jezusi e eliminoi fenë çifute.

Jezusi e bëri të qartë se kristianizmi është e vemja rrugë për të shkuar te Perëndia. Ai tha: «Unë jam udha, e vërteta dhe jeta; askush nuk vjen tek Ati përveçse nëpërmjet meje» (Gjoni 14:6). Pjetri tha: «Dhe në asnjë tjetër nuk ka shpëtim, sepse nuk ka asnjë emër tjetër nën qiell që u është dhënë njerëzve dhe me anë të të cilit duhet të shpëtohem» (Veprat 4:12).

Jezusi nuk vdiq që të shkaktonte ndarjen e njëërëzimit, me anë të krijimit të një morie sektesh "kristiane" që nuk pajtohen me njëri-tjetrin. Ai vdiq që t'i eliminonte ndarjet fetare.

Vini re çfarë tjetër bëri Jezusi. Në pjesën tjetër të vargut 15 thuhet: «Për të krijuar në vetvete nga dy një njeri të ri, duke bërë paqen.» Ai jo vetëm që prishi diçka, por Ai, në të njëjtën kohë, krijoi diçka. Çfarë donte të ndërtonte Jezusi? Ai erdhi për të krijuar në Vetvete një njeri të ri. Fjala «i ri» ka rëndësi. Ka dy fjalë greke të përkthyer «i ri». *Néos* do të thotë «i ri» në kohë (moshë). Diçka është e re në qoftë se është krijuar kohët e fundit. Fjala tjetër greke është *kainós* dhe do të thotë «i ri» në cilësi.

Diçka është e re në cilësi në se ka ndryshuar dhe është përmirësuar deri në atë masë sa duket tërësisht tjetër<sup>1</sup>.

Në vargun 15 Pali përdori fjalën e dytë, *kenós*. Ai donte që kristianët të vinin re se Jezusi erdhi për të krijuar një njeri të ri, një cilësi të ekzistencës njerëzore të panjohur më parë, një racë të re.

Në vargun 16 na tregohet diçka tjetër që Jezusi bëri. Na tregohet se çfarë kishte në mend Jezusi kur krijoi «njeriun e ri». Pali tha se Ai e krijoi njeriun e ri «për t'i pajtuar të dy me Perëndinë në një trup të vetëm me anë të kryqit, mbasi vrau armiqtë në vetvete».

Jezusi e bëri këtë në kryq. Ai pajtoi racën e tretë, krijesën e re, trupin e vetëm të Perëndisë. Ai pajtoi njerëzit me Perëndinë. Jezusi pajtoi, gjithashtu, njerëzit me njëri-tjetrin.

Robert Luis Stivenson tregoi një histori për dy motra të pamartuara që jetonin në një shtëpi me një dhomë gjumi. Ato ziheshin shumë me fjalë me njëra-tjetrën. Një ditë po diskutonin me zjarr për çështje fetare. Irritimi i tyre arriti kulmin dhe ato i folën njëra-tjetrës me aq urrejtje, sa vendosën të mos i flisnin fare njëra-tjetrës.

Kaluan ditë dhe muaj. Ato vazhdonin të jetonin me njëra-tjetrën pa folur. Asnjëra nuk kishte para të mjaftueshme të merrte shtëpi tjetër, kështu që qëndruan në një dhomë duke mos folur kurrë me njëra-tjetrën. Ato vizatuan me shkurtesh në dysheme një vijë që ndante territorin e secilës. Për vite ato e urryen njëra-tjetrën dhe nuk folën. Çdo natë secila prej tyre shkonte të flinte duke dëgjuar frymëmarrjen e tjetrës, d.m.th të armikes së saj. Ato jetuan në atë situatë të tmershme gjithë jetën e tyre.

Kjo nuk ndodh vetëm në romane, por ndodh edhe në jetën e përditshme. E kam parë këtë edhe në bashkësi kristianësh. Ndoshta nuk vizatojmë vija me shkurtesh në dysheme, por vijat janë atje. Njerëz që mbajnë emrin e Jezusit nuk ndërtojnë asnjë lloj marrëdhënieje me njëri-tjetrin. Ndjenjat që mbi-zotërojnë janë ndjenjat e superioritetit dhe të mendjemadhësisë.

Mund t'ju them, bazuar mbi pushtetin e Fjalës së Perëndisë, se armiqtë apo ndarja që mund të ekzistojë në trupin e Krishtit është në kundërshtim me vetë qëllimin e vdekjes së Krishtit. Jezusi erdhi për të pajtuar, për të krijuar një krijesë të re, të vetme e të bashkuar.

## KONKLUZION

Njerëzimi pa Krishtin është një rrëmuje e vërtetë. Lajmet, gazetat dhe përvojat personale mjaftojnë që të na bëjnë të shohim se bota jonë është e specializuar në ndarjen, largimin dhe armiqësinë. Është një botë pa Jezusin ku çdo njeri jeton vetëm për vete.

Në kontrast të thellë me këtë, kisha duhet të jetë një vend paqeje. Krishti i bën thirrje kishës së Tij që të bëjë gjithë përpjekjet për të rregulluar marrëdhëniet e prishura dhe kjo nën dritën e mësimëve të Perëndisë. Plani i Tij është që kisha të jetë një vend pajtimi dhe, kështu, të përfaqësojë denjësisht racën e re.

Për ta arritur këtë duhet të mendojmë me seriozitet për disa çështje.

Kurrë nuk do ta kuptojmë kristianizmin, në qoftë se nuk fillojmë të vlerësojmë rëndësinë e kësaj race të re për Jezusin. Trupi i Krishtit (kisha, kristianët) është vendi ku jeton kristianizmi.

Nuk mund ta kuptojmë kristianizmin në qoftë shikojmë se ka përçarje në bashkësinë lokale dhe nuk bëjmë gjithë ç'mundemi për ta eliminuar atë. Kisha (bashkësia) lokale duhet të jetë një vend ku të gjithë ne punojmë për të «fshirë vizat me shumës». Bashkësia e kishës së Zotit duhet t'i pranojë njerëzit, t'i përqafojë e t'i dojë ata. Çdo njeri që është në kishë duhet me të vërtetë të provojë atë që nuk mund ta gjejë në botën jashtë. Ai duhet ta shikojë me sytë e vet se është midis njerëzve të një race të re, portat e së cilës janë të hapura për të gjithë.

## SHENIME

<sup>1</sup>Kainós do të thotë «i ri» në kuptimin e diçkaje të papërdorur, jo të diçkaje «të re» në kohë, por «të re» për sa i përket cilësisë, apo natyrës së ndryshme nga ajo që ishte e vjetër. Néos do të thotë «i ri» në kohë, i kohëve të fundit. Néos dhe kenós nganjëherë përdoren me të njëjtin kuptim, por ka ndryshim midis tyre siç e shpjegoam më lart. Kështu, «njeriu i ri» te Efesianëve 2:15 (kenós) do të thotë i ndryshëm në cilësi, në karakter. Por «njeriu i ri» te Kolosianëve 3:10 (néos) thekson faktin se besimtari është «i ri» në përvojë, se sapo ka nisur rrugën dhe po vazhdon në të.

Autor: *Rusty Peterman*  
Marrë nga seria: “*Efesianëve*”  
© 2003 E VERTETA PER SOT  
Të gjitha të drejtat të rezervuara